

VENDIM
Nr.686, datë 11.10.2006

**PËR MIRATIMIN E MEMORANDUMIT TË BASHKËPUNIMIT, NDËRMJET
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KOMISIONIT
QENDROR TË ZGJEDHJEVE, PËR ZGJEDHJET E ARDHSHME TË ORGANEVE TË
QEVERISJES VENDORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Miratimin e memorandumit të bashkëpunimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për zgjedhjet e ardhshme për organet e qeverisjes vendore, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2.Ngarkohet zëvendëskryeministri, që, në emër të Këshillit të Ministrave, të nënshkruajë këtë memorandum, si dhe të ndjekë zbatimin e të drejtave dhe të detyrimeve, që përcaktohen në të.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI
PËR ZGJEDHJET E ARDHSHME PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE

Meqenëse së afërmi do të zhvillohen zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë;

Meqenëse Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Kodi Zgjedhor ngarkon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve me detyrën për të përgatitur, mbikëqyrur, drejtuar dhe verifikuar të gjitha aspektet, që kanë të bëjnë me zgjedhjet;

Meqenëse Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në zbatim të Kushtetutës, legjislacionit shqiptar në fuqi dhe të marrëveshjeve ndërkombëtare, ku shteti shqiptar është palë, është seriozisht i angazhuar për mbajtjen e zgjedhjeve të lira, të ndershme dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare;

Meqenëse për realizimin e këtyre standardeve kërkohet bashkëpunim serioz dhe i vazhdueshëm ndërmjet Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe strukturave shtetërore, në varësi të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë;

Duke marrë parasysh rëndësinë e madhe, që kanë këto zgjedhje për të ardhmen e vendit dhe në kuadër të marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit me Bashkimin Europian;

Si dhe për të realizuar, në shkallë institucionale, këtë bashkëpunim,

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë (më poshtë referuar si Këshilli i Ministrave) dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (më poshtë referuar si KQZ), nënshkruajnë këtë memorandum bashkëpunimi.

Palët nënshkruese të këtij memorandumit veprojnë në përputhje me statusin e tyre institucional, të përcaktuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kodin Zgjedhor dhe legjislacionin në fuqi.

Këshilli i Ministrave merr përsipër dhe i garanton KQZ-së:

- Nëpërmjet Ministrit të Financave:

-Financimin e procesit zgjedhor sipas kërkesave të KQZ-së, në mbështetje të legjislacionit në fuqi, për Buxhetin e Shtetit dhe procedurat e shpenzimeve buxhetore.

-Nëpërmjet Ministrit të Drejtësisë:

-Krijimin e lehtësive në lëshimin e vërtetimit të gjendjes gjyqësore, të kërkuar nga subjektet politike apo individë, në funksion të plotësimit të dokumentacionit ligjor, për efekte zgjedhore.

-Në bashkëpunim me Këshillin e Lartë të Drejtësisë, gatishmërinë e gjykatave të shkallës së parë në gjykimin e shpejtë të ankesave të zgjedhësve për përfshirjen e tyre në listën e zgjedhësve.

-Nëpërmjet Ministrit të Brendshëm:

-Asistencë për sigurimin e mjediseve për zyrat e KZQV-ve, të mjediseve për vendet e numërimit të votave dhe KQV-të;

-Asistencë për sigurimin e mjediseve për zyrat rajonale zgjedhore të KQZ-së;

-Sigurimin e mjediseve të nevojshme për zhvillimin e programeve të trajnimit që KQZ-ja do të organizojë për komisionerët e KZQV-ve, dhe të kqv-ve, duke shfrytëzuar mjedise, në administrim të prefektëve ose të njësive përkatëse të qeverisjes vendore, sipas kalendarit të përcaktuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve;

-Asistencë për shpërndarjen e bazës materiale zgjedhore dhe të fletëve të votimit për çdo KZQV;

-Nëpërmjet Ministrit të Mbrojtjes:

-Asistencë për transportin e bazës materiale zgjedhore dhe të fletëve të votimit në bashkitë dhe komunat e vendit, sipas grafikut të përcaktuar nga KQZ-ja.

-Vënien në dispozicion të KQZ-së, për nevoja emergjente, gjatë ditës së zgjedhjeve të një ose dy helikopterëve.

-Mbështetjen e KQZ-së me mjete të ndryshme transporti, në bazë të kërkesave të saj.

-Nëpërmjet Ministrit të Arsimit dhe Shkencës:

-Sigurimin e mjediseve të ndryshme, kryesisht, klasash mësimore dhe palestra shkollash për zhvillimin e seancave trajnuese me komisionerët zgjedhorë, si dhe zhvillimin e procesit të numërimit të votave.

-Nëpërmjet “Albtelecom” sh.a.-së:

-Asistencë për lidhjen me një linjë telefoni dhe faksi të zyrave të KZQV-se dhe vendeve të numërimit të votave në të gjithë vendin, duke mundësuar komunikimin e vazhdueshëm me KZQV-të, si dhe transmetimin e rezultateve paraprake.

KQZ-ja merr përsipër dhe i garanton Këshillit të Ministrave se:

-Në afatin e duhur do të nxjerrë aktet nënligjore, të detyrueshme për zbatimin nga organet jashtëzgjedhore.

-Do të identifikojë në nivel vendor mjediset e zyrave të KZQV-ve, vendeve të numërimit të votave, si dhe të mjediseve, që mund të shërbejnë për zhvillimin e seancave trajnuese.

-Do t'i sigurojë në kohë institucioneve të mësipërme të dhënat e duhura për realizimin e bashkëpunimit institucional, në funksion të administrimit të procesit zgjedhor.

Për respektimin e të drejtave dhe detyrimeve, që burojnë nga ky memorandum, palët veprojnë në bazë të kompetencave, që u njih ligji. Në këtë kuadër, palët njohin rolin drejtues të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në procesin e përgatitjes së zgjedhjeve, si dhe angazhimin e veçantë të strukturave të mësipërme, në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë.

Ky memorandum bashkëpunimi hyn në fuqi në çastin e nënshkrimit nga palët dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Tiranë më 2006